


## Kulturë

Abaz Hado, ish- drejtor i Galerisë Kombëtare të Arteve

## Galeria, jo vepra arti me tender



## Eric Vigner, një "Berber i Sevilyes" që flet shqip

Do të jetë një nga ato shfaqje që kanë të ndërthurur intrigën për hir të dashurisë, humorin, karakteret e tipizuara dhe kontrastin. Jo një kontrast vetëm në ngjyrat e skenografisë, por edhe real. Jo vetëm kaq, por edhe si një komedi shqiptare. Të tillë e ka konceptuar Eric Vigner, regjisori i famshëm francez, vëniën në skenën e Teatrit Kombëtar të shfaqjes "Berberi i Sevilyes" së Bomarshe. "Ishin fotografitë e Marubit në bardh e zi ato që më frymëzuan dhe kontrasti i tyre- u shpreh Vigner- si dhe veshjet karakteristike shkodrre, që më bënë të mendoj së pari për ta sjellë shfaqjen në një frymë shqiptare në skenën tuaj". Do të jetë një teatër muzikor, që nënkupton këngën, vallëzimin, recitimin dhe ekzekutimin muzikor me anë të instrumenteve violë dhe violonçel, nën kompozimin e virtuozyt Fatos Qerimi. Ai i ka krijuar këto melodi enkas për shfaqjen- shprehet Vigner- dhe jam mjaft i kënaqur nga kjo ndërthurje e veprës teatrore me muzikën live në skenë". Shfaqja sjell katër personazhe kryesorë, të veshur me kostume popullore të përshtatura me kohën e veprës nga stilistja Anila Zajmi. Ndërsa për ndriçimin ka punuar me mjeshtëri dora e artistit francez Pascal Noel. Në një bashkëpunim shqiptaro- francez, vepra sjell disa elemente regjisoriale nga Vasian Lami si asistent regjisor. Nën lojën e aktorëve të teatrit, të zgjedhur nga Vigner, do të vijnë në role berberi Figaro nga Helidon Fino, miku i tij Roland Trebicka si konti Almaviva, Luiza Xhuvani si Rozina, Neritan Liçaj si doktor Bartolo, bashkëshorti i saj, etj. Vepra ka një përshtatje të lirë në konceptim dhe Vigner thotë se ka marrë prej saj vetëm frymëzimin, ndërsa gjithçka tjetër ka rrjedhur si poezi, natyrshëm. Më pëlqen të punoj me dritën dhe hijen- shprehet Vigner- kontrastin që e shoh edhe tek karakteret. Kështu, Figaro dhe konti Almaviva të veshur me të bardha, i sjellin dritë shpëtim të Rozinës dhe doktorit, të veshur me të zeza. Ndërsa skenografia është tejet e thjeshtë. Ndërsa aktorët shqiptarë do të na shfaqen me cilësi që deri më sot nuk i kishim parë tek ta. "Është një eksperiencë e re për ne, në këtë formë: të këndojmë, vallëzojmë dhe interpretojmë si aktorë. Mendoj se të gjithë aktorët duhet të kenë të dhëna edhe në këto arte të tjera, për të qenë të kompletuar- shprehet Luiza Xhuvani- Jemi të kënaqur dhe është një eksperiencë shumë e bukur". Shfaqja do të zgjasë rreth dhjetë ditë, nga 19 deri në 29 Prill. Krahas me të, në skenën e re të teatrit kombëtar do të vihet edhe shfaqja "Apologjia e vërtetë e Sokratit", ndërsa ditët në vijim do të sjellin edhe premierat e fundit të TK, si "Kambanat e muzgut" apo "Korbi i bardhë" etj.

Ersejla MURATI

- Z. Hado, si ju duken zhvillimet e artit pamor sot në Shqipëri? Ku janë arritjet apo pikat e dobëta?

- Prej një kohë të gjatë jam duke ndjekur me vëmendje zhvillimet e artit pamor sot në vend, qoftë si krijues, qoftë si studiues i këtij lloji arti. Mendoj se progreset nuk mungojnë, megjithatë ashtu siç unë i kam ndjerë them se arti pamor duhej të kishte një impakt më të madh. Mungojnë ndërmarrjet e mëdha, të cilat kanë të bëjnë me atë që pikturat dhe skulpturat duhet të bëhen më të prekshme nga publiku i gjerë. Në këtë periudhë komplimentoj mbajtjen e një ekspozite me vlera si "Mitet", një ekspozitë shumë dinjitoze dhe po ashtu ekspozitën fotografike World Press Photo. Të dyja këto aktivitete tregojnë se kur bëhen aktivitete të tilla ato janë më të prekshme për publikun. Jam me idenë se Galeria e Arteve apo institucione të tjera të kulturës që lidhen me të, flas këtu për ministrinë e Kulturës, duhet të iniciojnë ide më të mëdha që të tërheqin më shumë vëmendje. Por çfarë ofron turizmi kulturor sot? Ne nuk kemi pika turistike ku të grumbullohen artistë dhe veprat e krijuara prej tyre tua pasqyrojnë turistëve. Në botë ekzistojnë të tilla qendra fare pranë pikave turistike bregdetare, siç kemi edhe ne qytetet e Vlorës, Sarandës, Shkodrës, Durrësit etj. Në këto pika turistike të vendit tonë nuk ka galeri arti për turistët e vizitorët, të huaj apo vendas. Edhe nëse ekzistojnë fizikisht këto godina, nuk ka aktivitet të mirëfilltë në to. Janë thjesht inaktive. Mendoj që është në përgjegjësinë e institucioneve të kulturës që në këto pika të forta për turizmin vendas të mbahen aktivitete permanente dhe të planifikuara mirë. Ne gjithashtu nuk kemi një ekonomi të artistëve, ndërkohë që në gjithë botën njihet kjo gjë.

- Po përse i përket Galerisë Kombëtare të Arteve dhe punës së saj deri më sot? Si e shihni ju, si ish- drejtor i saj?

- Mendoj se fondi i krijimtarisë së galerisë duhet të shtohet me krijimtarinë e viteve të fundit në artet pamore shqiptare. Për këtë, marr një shembull të freskët siç është muzeu i parë privat "Mezuraj", që ka edhe një pavion mjaft interesant me vepra të Ismail Lulanit. Kam mbetur i mrekulluar nga ato krijime, aq intime dhe shumë më artistike se ato që ka sot Galeria Kombëtare. Mendoj se kjo galeri nuk mund të marrë vepra arti me tender. Mendoj se edhe MTKRS duhet të inkurajojë sistemin e artit privat dhe të krijojë bashkëpunime me galeri apo muze private, si për lektorime, vizita, aktivitete kulturore të ndryshme, pse jo. Këto muze private, sikurse është edhe rasti i "Mezuraj" kanë një funksion edukativ shumë të mirë dhe janë ngritur mbi parametrat e duhura,



duke marrë për drejtues edhe një figurë të shquar. "Mezuraj" është një shembull shumë i qartë që galeria duhet të synojë, që të arrijë nivele të tilla.

- Meqë jemi tek funksioni edukativ, a e ka sot këtë aspekt Galeria Kombëtare?

- Mendoj se një sistem edukimi i mirë për të mësuar me artin këdo, nuk ekziston sot për sot në këtë galeri. Ndërkohë, që në kohën kur unë drejtoja këtë institucion e kisha si një synim edukimin me artin. Kujtoj këtu ardhjen e fëmijëve nga zona periferike e Tiranës, Bathorja, për të vizituar një ekspozitë pikturash në Galerinë Kombëtare. Jam emocionuar kur pashë se me sa qetësi dhe vëmendje e vizituan ata ekspozitën. Mendoj se çdo qytetar, çdo njeri duhet të edukohet me artet pamore dhe të njihet me vlerat dhe historinë e artit shqiptar në tërësi. Është detyra e Ministrisë së Kulturës dhe e Galerisë Kombëtare të Arteve që ta bëjnë të mundur këtë.

- A ka treg sot arti pamor në Shqipëri?

- Krijimtaria artistike sot nuk ka treg, gjë që bën që arti të jetë në dorë të minigalerive të qyteteve kryesore të vendit. Ato as galeri nuk mund të quhen, sepse kanë funksionin e shitjes së veprave. Janë dyqane arti. Aty

edhe veprat nuk janë të nivelit të artit të mirëfilltë. Një pjesë janë të kopjuara nga vepra të autorëve të huaj, një pjesë të punuara jo profesionalisht.

- Po porsa i përket restaurimit të veprave me vlera, si ajo e Kol Idromenos, çfarë duhet bërë më tej?

- Piktura si "Motra Tone" kanë vlera dhe një nga krenaritë e mia si drejtor për atë kohë në këtë galeri ishte pikërisht që arrita të bëj të mundur dërgimin e saj për restaurim në Francë. Ishte një bashkëpunim i asaj kohe edhe me drejtoreshën e Muzeut të Firences, që ne të vazhdonim në udhën e restaurimeve nga këto muze me emër, që kanë mundësitë të ofrojnë shërbime të cilësisë më të lartë që kërkohet për këto vepra. Njohja ime me galerinë është e brendshme dhe detyra ime si drejtor i saj pak kohë më parë ishte që Galerinë t'ia ofronim publikut. Ekspozimi është një pjesë e vlerave të krijimeve, por pjesa e mirëmbajtjes është ajo që i shërben të parës, vlerave të veprave. Kështu, ne nuk bëjmë gjë tjetër veçse duke i mirëmbajtur i bëjmë ato më jetëgjata. Synimi im ishte që të ndërtonim një laborator dhe një ambient për mirëmbajtjen e fondit të galerisë në pjesën e pasme të godinës. Ky projekt do të kishte mbështetjen e

një prej shteteve më të fuqishme të botës, por nuk u bë e mundur për shkak të largimit tim nga detyra. Për vitin 2006 ata do e sillnin këtë fond drejtpërdrejtë në galeri, pa kaluar më parë nga buxheti i shtetit. Ndër 5000 vepra që sot ka galeria, jo të gjitha mund të trajtohen njësoj. Për këto unë kërkova ngritjen e një këshilli që të kategorizonte veprat në tre rrate: atë të artit, të argjendit dhe veprat që mund të shiteshin me ankand, pasi nuk shërbenin më galerisë as për ekspozim dhe as për vlerat që na i kishin. Kjo mënyrë funksionon në gjithë botën. Kështu, ndër dhjetëra pllakata nga arti i periudhës komuniste, nuk kishim pse të mbanim aq, por t'i shisnim me ankand për koleksionistë privatë apo muze të botës që i blejnë të tilla vepra. Në këtë mënyrë, krijohet një fond që i shërben pikërisht mirëmbajtjes atyre veprave që vërtet vlejnë. Në kohën time si drejtor i galerisë, krijua një fond prej 120- 130 mijë euro vetëm nga falja e veprave. Mendoj se sot më shumë kjo galeri ka nevojë të bëhet më e vëmendshme ndaj veprave të reja me vlera, që sjellin zhvillimet e artit pamor dhe të restaurojnë ato vepra të së kaluarës, që vërtet bartin vlera në historinë e artit pamor.